



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1397/2 Prot.

Tiranë, më 28. 7. 2022

V E N D I M

Nr. 24, datë 27.07.2022

Për miratimin e “Strategjisë institucionale për mësimdhënien
Universiteti i Tiranës 2022-2027”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 1, germa “d” dhe në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, germa “c”, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Strategjinë institucionale për mësimdhënien Universiteti i Tiranës 2022-2027”.
2. Vendimi i përcillet të gjitha njësive përbërëse të UT-së.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

STRATEGJIA INSTITUCIONALE

PËR MËSIMDHËNIEN

UNIVERSITETI I TIRANËS
2022-2027

Miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 24, datë 27.07.2022

Tiranë





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

Grupi i punës:

Prof.dr. Anila Paparisto
Prof.asoc.Dr. Gentiana Kera
Prof.asoc.Dr. Rezarta Peri
Prof.asoc.Dr. Marinela Sota
Dr. Suela Maxhelaku
Msc. Ina Veleshnja
Dr. Rudina Xhillari
Dr. Elena Polo
Msc. Gani Demiraj
Znj. Elena Shumbulli
Znj. Dea Alla
Prof.asoc.Dr. Linda Mëniku
Prof.dr. Rajmonda Duka
Prof.asoc.dr. Çlirim Duro





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

PËRMBAJTJA

I. HYRJE

II. MËSIMDHËNIA DHE STUDIMET NË PLANIN STRATEGJIK TË ZHVILLIMIT TË INSTITUCIONIT 2018-2023

III. OBJEKTIVAT E STRATEGjisë SË MËSIMDHËNIES 2022-2027





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

HYRJE

Universiteti i Tiranës është institucioni i arsimit të lartë publik më i madh në Shqipëri dhe njëkohësisht më i vjetri. Në vitin 2018 u miratua nga Senati Akademik i Universitetit të Tiranës Strategjia e Zhvillimit të Institucionit, e cila përfshinte edhe një kapitull mbi Mësimdhënien dhe studentët.

Objektivat kryesorë në stategjinë e zhvillimit të institucionit në lidhje me mësimdhënien janë:

- Studentët përfitojnë gjatë studimeve të tyre jo vetëm njohuritë shkencore në fushat përkatëse të studimit dhe disiplinat e përafërtë, por edhe aftësi sociale dhe personale, si dhe kompetenca të tilla që u mundësojnë atyre integrimin në botën e së ardhmes dhe promovimin vetjak për zhvillimin personal dhe atë social.
- Studentëve iu ofrohen kushte të përshtatshme për udhëheqjen nga personeli akademik gjatë të gjithë periudhës së studimeve në të gjitha ciklet e studimit.
- Universiteti i Tiranës ofron programe studimi të orientuara drejt kërkimit shkencor, sidomos në programet e ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve.
- Universiteti i Tiranës ka gjithnjë në vëmendje hartimin e politikave për lehtësira fiskale dhe infrastrukturore për studentët nga shtresat në nevojë dhe personat me aftësi të kufizuara, me qëllim ofrimin e mundësive të barabarta për të gjithë.
- Rishikimi i planeve mësimore me qëllim rritjen e përqindjes së lëndëve me zgjedhje për t'u mundësuar studentëve që të kenë mundësinë për zgjedhjet e tyre personale në përpilimin e planeve mësimore.

Universiteti i Tiranës është një universitet publik që ofron një gamë të plotë të programeve në të tria ciklet e studimit duke u mundësuar studentëve një qasje të gjerë. Programet e studimit në UT kanë për qëllim të përbashkët zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë në shërbim të lirisë e të diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit të së drejtës, për rritjen e mirëqënieve e dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente.

Të gjitha programet e studimit në UT kanë si emërues të përbashkët nxitjen e mendimit kritik dhe krijues me qëllim zhvillimin e frysë së qytetarisë demokratike, krijimin e një hapësire publike





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

universitare që karakterizohet nga debat i lirë, serioz dhe me përkushtim ndaj së mirës publike. Universiteti i Tiranës e konsideron veten si një institucion që synon t'i orientojë studentët drejt të menduarit analistik dhe ndërdisiplinor dhe t'i përgatisë ata për konkurrencën në tregun e punës. Studentëve, krahas njojurive në disiplinat përkatëse të studimit dhe disiplinave të përafërtë, duhet t'u ofrohen edhe aftësi të tjera të nevojshme për të përgatitur jo vetëm profesionistë të mirë, por edhe qytetarë të angazhuar në shoqëri.

Ky plan strategik për mësimdhënien përcakton parimet udhëzuese për objektivat dhe strategjitë e zbatimit në fushën e mësimdhënies që duhet të mbahen parasysh në mënyrë që UT-ja të përballojë sfidat aktuale dhe ato të së ardhmes. Duke ndjekur parimin e kombinimit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, këto veçori duhet të zbatohen në të gjitha programet e studimit që ofron Universiteti i Tiranës, veçanërisht në programet e ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve. Universiteti do të vazhdojë të përmirësojë cilësinë e programeve në të tria ciklet e studimit. Me qëllimin për të tërhequr më shumë studentë të huaj do të synohet rritja e ofertës së mësimdhënies në gjuhë të huaj në programet e studimit, sidomos në programet e ciklit të dytë dhe të tretë.

Plani strategik përcakton linjat themelore të veprimit dhe krijon kornizën kuadër për performancën e Universitetit të Tiranës në mësimdhënie për vitet 2022-2027 me qëllim realizimin e vizionit të UT-së, të përcaktuar në nenin 4 të statutit: “Universiteti i Tiranës synon të mbetet model i arsimit të lartë publik, i karakterizuar nga përgatitje rigoroze akademike dhe kërkim i thelluar shkencor, një institucion arsimor i zgjedhjes së parë për studentët e angazhuar në transformimin e jetës së tyre dhe të shoqërisë” dhe misionit të përcaktuar në nenin 5 “Universiteti i Tiranës është një universitet publik që ofron gamë të plotë të programeve të nivelit bachelor, master dhe studime doktorale. Universiteti kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, përmes tri shtyllave të misionit të arsimit të lartë publik: kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut, që vazhdimesh e pasurojnë dhe e informojnë njëra-tjetrën. Ne ofrojmë edukim me në qendër studentin, si dhe nxisim rritjen personale dhe intelektuale, për të përgatitur studentë për karriere produktive dhe qytetare, të përgjegjshëm në një shoqëri globale”.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

OBJEKTIVAT E STRATEGJISË SË MËSIMDHËNIES 2022-2027

Objktivi 1. Krijimi i mundësive për të gjithë studentët për të zhvilluar potencialin e tyre duke ofruar një mjeshtësia jo vetëm mbështetës, por edhe stimulues që nxit fryshten e konkurrencës pozitive e që synon, gjithashtu, jo vetëm pajisjen e studentëve me njohuritë, aftësitë dhe eksperiencat për të qenë të diplomuar të suksesshëm, por synon kryesisht në formimin e tyre të përgjithshëm me kompetenca dhe aftësi të tillë bazë, të cilat ata mund t'i zhvillojnë më tej në gjithë harkun kohor të jetës duke u bërë lider të së ardhmes dhe duke kontribuar me sukses në shoqëri.

Veprimtaritë për realizimin e objektivit strategjik

- 1.1 Përdorimi i kurrikulës për të nxitur përfshirjen, barazinë dhe diversitetin.
- 1.2 Krijimi i një mjeshtësia digital të të mësuarit që mundëson angazhim aktiv të studentit.
- 1.3. Krijimi i një mjeshtësia digital për një qasje sa më bashkëkohore që mundëson një angazhim sa më aktiv të studentit.
- 1.4 Krijimi i hapësirave të specializuara për mësim praktik.
- 1.5 Zbatimi i politikave të krijimit të lehtësirave fiskale dhe infrastrukturore për studentët nga shtresat në nevojë personat me aftësi ndryshe.
- 1.6 Shtimi i mobiliteteve të studentëve.
- 1.7 Nxitja e zhvillimit të aftësive sociale dhe komunikuese.

Objktivi 2. Lidhja e programeve të studimit me tregun e punës

Veprimtaritë për realizimin e objektivit strategjik

- 2.1 Rishikimi i vazhdueshëm i dokumenteve bazë të procesit mësimor dhe plotësimi i tyre cilësor me qëllim garantimin e një oferte studimi tërheqëse për studentët dhe në përshtatje të vazhdueshme me nevojat e tregut dhe shoqërisë.
- 2.2 Harmonizimi, në programet profesionale që organizojnë studime për profesione të rregulluara me ligj, mes dijeve të marra gjatë programit të studimeve profesionale dhe dijeve për të cilat kandidatët testohen në provimin e licensimit.
- 2.3 Diversifikimi i praktikave dhe institucioneve publike dhe private ku zhvillohen praktikat mësimore të parashikuara në planet mësimore të programeve të studimit.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

- 2.4 Analiza e vazhdueshme e punësimit të studentëve pas diplomimit sipas degëve përkatëse.
- 2.5 Konsolidimi i zyrave të këshillimit të karrierës
- 2.6 Zgjerimi i bazës së të dhënave të ALUMNI.
- 2.7 Realizimi i projekteve të përbashkëta me shoqatat e bizneseve për transferimin e teknologjisë.
- 2.8 Ofrimi i programeve profesionale të shumëllojshme.
- 2.9 Zgjerimi i programeve të praktikave të studentëve në bashkëpunim me institucionet shtetërore, publike, kompanitë private dhe publike, organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare dhe ente të tjera sipas profilit të programit të studimit duke mundësuar realizimin e partneriteteve innovative, si dhe krijimin e mundësive të punësimit për studentët e diplomuar.

Objktivi 3. Zhvillimi i kurrikulave, rezultateve të të nxënësve, vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë që marrin në konsideratë aftësitë e nevojshme për sfidat aktuale dhe të ardhshme të shoqërisë

Veprimtaritë për realizimin e objektivit strategjik

- 3.1 Hartëzimi i rezultateve të të nxënësve dhe kompetencave bazë për programet e studimit që përgatisin mësues dhe rishikimi i programeve të mësuesisë.
- 3.2 Rishikimi dhe hartëzimi i rezultateve të të nxënësve për programet e studimit në përputhje me modelin e bazuar në rezultatet e të nxënësve.
- 3.3 Përdorimi i teknologjive digitale në mësimdhënie.
- 3.4 Pasurimi i mëtejshëm i bibliotekave të njësive përbërëse të UT-së.

Objktivi 4. Kërkimi i rrugëve për të zbatuar metoda të reja dhe inovative të mësimdhënieve me në qendër studentin, me fokus tek qasjet ndër- dhe shumëdisiplinore, mësimdhënien dhe të nxënësve e bazuar tek kërkimi shkencor.

Veprimtaritë për realizimin e objektivit strategjik

- 4.1 Nxitja e mësimdhënieve praktike me në qendër studentin, e përqendruar tek kërkimi shkencor.
- 4.2 Nxitja e mobilitetit të studentëve mes fakulteteve të Universitetit të Tiranës përmes ofertës për ndjekjen e leksioneve të ofruara në fakultetet e tjera dhe njohjes së krediteve.
- 4.3 Përfshirja e kërkimit shkencor në mësimdhënie.
- 4.4 Përfshirja e studentëve në projektet kërkimore.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

4.5 Ofrimi i programeve të studimit të orientuara drejt kerkimit shkencor në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve.

Objktivi 5. Promovimi i formimit të vazhduar për personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ

Veprimtaritë për realizimin e objektivit strategjik

5.1 Krijimi i programeve me mikro kredite për aftësi dhe kompetenca specifike për studentët për edhe persona të punësuar.

5.2 Organizimi i stazheve dhe i moduleve profesionale për rikualifikime dhe riformime teorike, dhe i shkollave verore apo formave të tjera.

5.3 Bashkëpunimi me bizneset për të përcaktuar nevojat që kanë për kualifikimin e mëtejshëm të personelit të tyre dhe organizimin e programeve me mikro kredite që u përgjigjen nevojave të tyre.

5.4 Shtimi i mobiliteteve.

5.5 Krijimi i shkollës së formimit të vazhdueshëm pedagogjik-psikologjik të lektorëve të rinj, në nivel institucional.

Objktivi 6. Lidhja e universitetit me shoqërinë, forcimi i dimensionit social të universitetit

Veprimtaritë për realizimin e objektivit strategjik

6.1 Forcimi i angazhimit të UT-së për përgjegjësitë sociale përmes projekteve konkrete.

6.2 Krijimi dhe vënia në dispozicion e përvojave sociale dhe kulturore për komunitetin.

6.3 Zhvillimi dhe përcjellja e informacioneve rreth UT-së, me qëllim informimin mbi aktivitetet e angazhimit dhe komunikimit publik

6.4 Zgjerimi i pjesëmarres dhe vullnetarizmit të studentëve dhe ndikimit të tyre në shoqëri

6.5 Zgjerimi i bashkëpunimit të universitetit me institucione publike dhe private me qëllim lehtësimin e transferimit të dijeve, përshtatjen me nevojat e tregut të punës dhe rritjen e ndikimit të UT-së në shoqëri.

6.6 Zgjerimi i mëtejshëm i mundësive për studentët për të ndërmarrë një gamë të gjërë të angazhimeve vullnetare në bashkësinë lokale





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

6.7 Organizimi i konferencave kombëtare dhe ndërkontinentale dhe i aktiviteteve të tjera shkencore që synojnë jo vetëm përfshirjen e studiuesve dhe studentëve, por që i adresohen edhe publikut të gjerë.

6.8 Organizimi i aktiviteteve kulturore në bashkëpunim me institucione të ndryshme dhe ambasadat e huaja në Shqipëri.

Objktivi 7. Identifikimi i nevojave të personelit akademik për zhvillim profesional në mësimdhënie dhe kërkim shkencor dhe përmirësimi i kushteve të punës

Veprimitaritë për realizimin e objektivit strategjik

7.1 Përmirësimi i infrastrukturës akademike.

7.2 Krijimi i një qendre virtuale të zhvillimit profesional dhe trajnimeve.

7.3 Trajnimi i personelit të ri akademik për formimin pedagogjik dhe psikologjik.

7.4 Nxjerra e të mësuarit nga kolegët.

7.5 Organizimi i trajnimeve për rritjen e kapaciteteve.

7.6 Përcaktimi në nivel universiteti i kompetencave të koordinatorëve për çdo program studimesh.

